




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Pranuar - Primitjano Më/Dana 08.04.2022		Vitet	
Nr./ organit Org.broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
01-110/05		-395	



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, shkronja d, neni 40, paragrafi 2, shkronja e dhe neni 51 paragrafi 2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), Udhëzimin Administrativ MAPL-05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen e kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë, neni 36 shkronja d, neni 40, 47 shkronja e të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 31.03.2022, merr këtë:

## V E N D I M

### për formimin e Komitetit për Komitetin për Shërbime Publike

#### Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për formimin e Komitetit për Shërbime Publike të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

#### Neni 2

Komiteti për Shërbime Publike ka 5 (pesë) anëtarë dhe atë:

1. Basri Sylejmani, anëtar i Kuvendit, përfaqësues nga subjekti politik LDK
2. Taipe Ibrahimimi, anëtare i Kuvendit përfaqësuese nga subjekti politik LDK
3. Sejdi Emimi anëtar i Kuvendit përfaqësuese nga subjekti politik LVV
4. Besiana Selmani , anëtare nga jashtë Kuvendit
5. Mubekir Shaqiri, anëtar nga jashtë Kuvendi

Komitetit Shërbime Publike, në mbledhjen e parë do ta zgjedh kryesuesin e këtij komiteti.

#### Neni 3

Komiteti, nga neni 1 i këtij vendimi, ka për detyrë që të shqyrtoj çështje të cilat kanë të bëjnë me shërbimet publike për Komunën e Vitisë dhe të jep vërejtje, propozime dhe sugjerime për lëmin e shërbimeve publike. Kryesuesi i Kuvendit, drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë dhe kryesuesi i këtij Komitet me detajisht mund të përcaktoj detyrat e këtij komiteti.

#### Neni 4

Anëtarët e Komitetit për Shërbime Publike, të emëruar në neni 1 të këtij vendimi, emërohen me mandat të njëjtë si të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

#### Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi do te kujdesen kryesuesi i Kuvendit dhe kryesuesi i Komitetit.

#### Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit;
2. Anëtarëve të Komitetit; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË

K R Y E S U E S I

Bekim Azizi

